

Joint German-Danish "Support to Agriculture and Rural Economic Development of Disadvantaged Mountainous Areas" (SARED)

PN (number): 12.2061.5-002.00

Implementing partner:

Shoqata Shqiptare e Marketingut (AAM)



Capacity Development Initiative:

Rritja e të ardhurave për prodhuesit dhe grumbulluesit e BAM në zonën e Shkodrës (2 grupe, respektivisht në Shkrel dhe Tamarë)

Raporti i parë

31 Korrik 2016

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqata Shqiptare e Marketingut (AAM) është kontraktuar nga programi SARED për të përmirësuar situatën e zinxhirit të vlerës për BAM në zonën e Shkodrës.

Në këtë kontekst, AAM me mbështetjen e SARED, është angazhuar në identifikimin e aktorëve të zinxhit të vlerës për BAM në zonat e Shkrelit dhe Tamarës për të formuar grupet dhe sëbashku me to ka zhvilluar një projekt propozim për zhvillimin e zinxhirit të vlerës për BAM në tregun lokal.

AAM ka një eksperiencë të gjerë në iniciativat për zhvillimin rural dhe përfaqsimin e BAM duke mbështetur grupet e fermerëve dhe prodhuesve në rritjen e kapaciteteve të tyre në përmirësimin e prodhimit dhe aksesit në treg duke përmirësuar kështu situatën e tyre ekonomiko – sociale. Në anën tjetër, Shkodra është e mirënjohur për pasurinë e saj me bimë të egra medicinale, një aset i ofruar nga kushtet specifike klimaterike dhe gjeografike. Duke konsideruar disa faktorë rajonal të tilla si niveli i ulët i të ardhurave, forca e disponueshme e punës, potenciali shumë i lartë në sasi dhe cilësi të bimëve të egra medicinale dhe aromatike si dhe ofertën e munguar në treg për produkte nga BAM, u ndërmor një iniciativë për zhvillimin e këtij zinxhiri vlere në Shkodër. Përmes kësaj ndërhyrjeje në të dyja zonat, në Shkrel dhe Tamarë,

Joint German-Danish “Support to Agriculture and Rural Economic Development of Disadvantaged Mountainous Areas” (SARED)

pritet të arrihen disa impakte të rëndësishme. Rezultatet kryesore do të jenë rritja e të ardhurave për prodhuesit e BAM në këto zona si dhe diversifikim të produkteve më cilësore të BAM dhe çajrave bimorë në tregun lokal. Aktivitetet e propozuara synojnë gjithashtu të rrisin aftësitë e përfituesve të përfshirë në këtë iniciativë (mbledhësit e BAM, përpunuesve, tregtarëve, etj) duke ndikuar dukshëm në cilësinë e produkteve finale, duke patur ndikim social në rajon, mjedis, si dhe ndikim të konsiderueshëm në zhvillimin e agroturizmit dhe promovimin e vlerave të rajonit.

2. Situata specifike

Zonat e Shkrelit dhe Tamarës janë ndër zonat më të varfëra në rajon. Në këto zona disa nga prodhimet bujqësore shkojnë për konsum familjar, ndërkohë që pjesa tjetër, e cila është një sasi e konsiderueshme, humbet për shkak të vështirësisë për të arritur tregun (infrastrukturë e dobët tregu), mungesa e kapaciteteve për përpunim (bimëve medicinale, frutave, etj) si dhe vështirësi për të patur akses në treg. Produkte të përpunuara të destinuara për treg pothuajse nuk ekzistojnë në Shkrel, ndërsa në Tamarë ekzistojnë vetën disa iniciativa të mbështetura nga organizata zhvillimi, por ende mungon fokusi drejt tregut dhe promovimit të produkteve.

Në të dyja zonat, grupet e synuara në të cilat është i fokusuar ky projekt janë: mbledhësit e bimëve medicinale, përpunuesit e produkteve të ndryshme me bazzë BAM, siç janë: reçeli i frutave të pyllit, çajrave bimorë, etj, grumbulluesit, tragtuesit e BAM dhe të gjithë ata të cilët i shtojnë vlerë zinxhirit të vlerës të BAM; grupet potenciale të synuara janë grupe të tjera fermerësh dhe shoqatash të lokalizuara në këto rajone; operatorë të agroturizmit (në veçanti restorantet dhe pikat e shitjeve ku do të promovohen produktet lokale) dhe grupe të tjera si konsumatori shqiptar dhe supermarketet.

Keshtu, në fshatin e Vrithit janë 16 gra të cilat kanë rënë dakord të bashkëpunojnë për zhvillimin e zinxhirit të vlerës të BAM. Të gjitha gratë janë banore të fshatit të Vrithit dhe kanë firmosur një Memorandum Bashkëpunimi. Nuk ka asnjë grumbullues apo shitës me shumicë pjesë të këtij grupi (i cili mund të mbështesë grupin me aktivitetet e magazinimit, tharjes, seleksionimin, përpunimit, dhe paketimit), por grate janë të hapura për të bashkëpunuar me përpunues afër zonës së tyre. Së fundmi, 2 gra të tjera i janë bashkëngjitur grupit të tërhequra nga inovacionet dhe rezultatet e pritura.

Joint German-Danish "Support to Agriculture and Rural Economic Development of Disadvantaged Mountainous Areas" (SARED)

Grupi i Tamarës është i përbërë nga 20 gra të cilat kanë firmosur Memorandumin e Bashkëpunimit dhe kanë rënë dakord për të bashkëpunuar për këtë projekt. Gratë janë nga zonat e fshatit Selcë, fshatit Tamarë dhe fshatit Broj që përfshihen në rajonin e Tamarës. Në këtë grup nuk ka patur ndryshime në numrin e grave që përbejnë grupin.

Pjesë e këtij grupi është dhe gruaja e një grumbulluesi, i vendosur në fshatin e Tamarës I cili do të shërbejë si pikë grumbullimi dhe mund të shërbejë gjithashtu si përfaqësues i grupit për të menaxhuar porositë për produkte, magazinimin dhe përpunimin e bimëve dhe infrastrukturën e shpërndarjes. Anëtarët e tjerë të grupit përfaqësojnë fermerë/mbledhës të BAM, si dhe tre nga gratë janë mësuese në shkollën e fshatit Tamarë.

Grupet tashme kanë marrë disa trajnime teknike për mbledhjen dhe përpunimin e bimëve të egra medicinale dhe aromatike (tharja, seleksionimi, etj) dhe disa tema mbi përpunimin e frutave të pyllit të zonës në reçel dhe likere si produkte të reja të zhvilluara me potencial të lartë për tregun lokal, duke sjelle dhe rritje të të ardhurave për aktorët e përfshirë. Për më tepër, rritja e aftësive mbi skemat e standarteve të cilësisë (p.sh. staandarti Garancia Shqiptare) përmes trajnimeve përkatëse, kanë rritur ndërgjegjësimin e grave mbi rëndësinë e prodhimit të produkteve me cilësi të lartë dhe mbi përfitimet e promovimit të vlerave dhe oportuniteteve të rajonit (lidhur me agroturizmin, shitjet në fermë, etj).

Gjatë sesioneve të trajnimit pjesëmarrja e grave ka qenë mjaft aktive sidomos në diskutimet mbi praktikatat më të mira dhe kërkesat për produkte me cilësi të lartë, në fokusimin në përfitimet potenciale që mund të gjenerojë grupi (p.sh. vlera e shtuar në produktet finale, zhvillimi i produkteve të reja dhe shitjet, etj). Përmirësimi i metodave të mbledhjes së bimëve duke përdorur pajisjet dhe mjetet e duhura përdorimi i teknikave të duhura për procesin e tharjes së BAM, përdorimi i teknologjive inovative për përpunimin e produkteve në reçel dhe likere do të çojnë në reduktimin e kohës së përpunimit, produkte me cilësi më të lartë, diversifikim të portofolit të produkteve, rritje të sasisë së prodhimit dhe si rrjedhim duke ndikuar në rritjen e çmimit final të produktit. Pritet, që të gjitha këto ndërhyrje të influencojnë në rritjen e të ardhurave për grupet e grave duke përmirësuar në këtë mënyrë situatën e tyre ekonomiko-sociale dhe promovimin të zonës.

3. Rezultatet sipas Log Frame

Objektivat	Indikatorët e verifikueshëm	Komente
Component 2: Rritja e prodhimit të BAM dhe të të ardhurave me 30%	Rritja e prodhimit me 30% Rritja e të ardhurave me	Ky rezultat planifikohet që arrihet në fund të projektit. Përmirësimet përmes aktiviteteve të planifikuara në nivele të ndryshme (teknike, marketing, promovim, etj) do të

Joint German-Danish "Support to Agriculture and Rural Economic Development of Disadvantaged Mountainous Areas" (SARED)

	30%	çojnë në arritjen e këtyre rezultateve. Tashme kanë filluar të zhvillohen sesionet e trajnimeve teknike dhe janë konsideruar si mjaft të vlefshme nga aktorët në përmirësimin e cilësisë së produkteve të reja të zhvilluara, mbrojtjes së mjedisit dhe promovimit të rajonit.
Rezultatet (të zbatuara për çdo hap)	Indikatorët e verifikueshëm	Komente
R1 - 34 fermerë të BAM janë trajnuar dhe udhëzuar për të prodhuar BAM cilësore.	34 fermerë të BAM kanë përmirësuar prodhimet e tyre sipas standarteve të miratuara	Deri më tani 38 pjesëmarrëse kanë ndjekur trajnimet e zhvilluara në të dyja zonat. Sipas këshillave të ekspertëve, grupet e grave po analizojnë mundësitë lidhur me standartizimin e produkteve të tyre sipas skemave të ndryshme të standartizimit (produkte tipike, organike, etj). Aktualisht ky është një proces në vazhdim.
R2 Aplikimet për investime në fermë dhe përmirësimin e procesit të përpunimit.	Grupet e përfshira janë dakord mbi numrin e investimeve dhe procedurat që do të ndiqen nga grupi për të mbështetur aplikusin	Trajnimet teknike të zhvilluara për përmirësimin e procesit të përpunimit të BAM kanë identifikuar investimet e nevojshme për prodhimin e produkteve BAM cilësore, ruajtjen e bimëve të egra medicinale dhe aromatike dhe mbrojtjen e mjedisit. Këto investime përfshijnë mjete/pajisje/material të tilla si: mjete të tjeshta prerjeje, doreza për mbledhje të bimëve, çanta të përshtatshme për mbledhjen e bimëve, rrjeta për seleksionimin dhe tharjen e bimëve, enë për gatimin e reçelit, soba për përgatitjen e reçelit, mjete të thjeshta për përgatitjen e

Joint German-Danish "Support to Agriculture and Rural Economic Development of Disadvantaged Mountainous Areas" (SARED)

		reçelit, etj. Gjithashtu, gjatë sesioneve të trajnimit aktorët e Zinxhirit të Vlerës kërkuan mbështetje për paketim, etiketim dhe brandim të produkteve të tyre. Ky proces është në vazhdim.
R3 Identifikimi i tregut për BAM	Grupi I Zinxhirit të vlerës është duke prodhuar sipas kërkesave të tregut.	Temat e trajnimit lidhur me çështjet e tregut janë planifikuar të zhvillohen në muajt në vijim. Këto trajnime pritet të rrisin njohuritë e pjesëmarrësve lidhur me kërkesat konkrete të tregut dhe kërkesat respektive lidhur me cilësinë në termat e mbledhjes dhe produkteve të përpunuar të BAM. Megjithatë, disa trajnime të zhvilluara deri më tani, I kanë pajisur grupet e grave me informacion rreth kërkesave të tregut për BAM e mbledhur dhe nevojën për të nisur negociatat me eksportuesit, grumbulluesit dhe përpunuesit e BAM. Trajnime të tjera lidhur me kërkesat e tregut pritet të sigurojnë gjithashtu informacion për produktet e përpunuara me bazë BAM.
R4 identifikimi i kanaleve më fitimprurëse të shpërndarjes	Përdorimi nga Grupi i Zinxhirit të Vlerës i kanaleve të shpërndarjes të indentifikuara	Informacioni i ofruar gjatë sesioneve të trajnimit mbi mënyrën e përpunimit të produkteve me cilësi të lartë të BAM (sëbashku me sesionet e trajnimit të marketingut) do të identifikojnë mundësitë për të ofruar këto produkte në kanale të reja shpërndarjeje të tilla si pika grumbullimi, restorante, agjensi turistike, bujtina, etj, si disa nga tregjet lokale më tërheqëse për rajonin. Në disa trajnime lidhur me përpunimin e BAM, ekspertet kanë ndarë informacione mbi logjistikën dhe kanalet e mundëshme të shpërndarjes të disa nga grumbulluesit dhe përpunuesit kryesorë të

Joint German-Danish "Support to Agriculture and Rural Economic Development of Disadvantaged Mountainous Areas" (SARED)

		BAM. Në trajnimet ne vijim këto informacione do të zhvillohen më tej dhe do të lobohet potencialisht me aktorë të tillë për të bashkëpunuar me grupet e grave lidhur me kanalet e shpërndarjes.
R5 Testimi i tregut	Pjesëmarrja në paraire Shpërndarje direkte që rezulton në rritjen e kërkesës së blerësve/konsumatorëve	Asnjë impakt akoma për këtë rezultat. Aktivitetet lidhur me këtë rezultat janë planifikuar të zbatohen në muajt në vijim.
R6 implementimi i strategjisë marketing	Grupet e Zinxhirit të Vlerës zbatojnë strategjinë e marketingut në proceset e tyre të prodhimit në fermë. Grupet e Zinxhirit të Vlerës kanë arritur një nivel të një grupi prodhuesi të qëndrueshëm të një cilësie homogjene.	Këto aktivitete janë planifikuar të zbatohen në muajt në vijim. Kjo temë është e lidhur fuqimisht me konceptet marketing që duhet të zhvillohen për produktet, prodhimin e organizuar dhe të standartizuar, etj. Gjithësesi, kanë filluar diskutimet paraprake mbi përfaqësuesin e mundshëm të grupeve për të ndihmuar grupin në aktivitetet në tregun lokal.